



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:214262

Datë: 24.05.2023

Numri i dokumentit: 04317412

PA1.nr.1924/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Kadrije Goga Lubishtani - kryetare e kolegjit, Skender Çoçaj dhe Ferit Osmani, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale ndaj të akuzuarit E. O., nga P., për shkak të veprës penale në Kanosja, nga neni 181 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit E. O. av. N. M. , të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1172/22, datë 14.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12.05.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit E. O., av. N. M. , ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1172/22, datë 14.11.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin, P.nr.1172/22, datë 14.11.2022, të akuzuarin E. O. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Kanosja, nga neni 181 par.4 lidhur me par.2, të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve. Në kuptim të nenit 44 të KPK-së, me propozimin e të akuzuarit, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej (njëmijë e pesëqind) 1.500 €, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, nga data 17.10.2022 deri më datën 14.11.2022 ashtu që i dënuari është i obliguar që ta paguaj dënimin me gjobë në shumën prej 940 (nëntëqindën e katër dhjete) €, i akuzuari dënimin me gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj dënimin me gjobë gjykata mundë ta zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burg, ashtu që për çdo 20 (njëzet) €, do ti caktohet 1 (një) ditë burgim. Është obliguar i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të

paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro, në emër të ekspertit mjeko-ligjor shumë prej 20 (njëzet) € dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit duhet të paguajë shumë prej 30 (tridhjetë) €, të gjitha këto në afat ligjor prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur :

Mbrojtësja e të akuzuarit E. O. av. N. M. , për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit të i shqiptoj dënim më të ultë.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/II.nr.13/2023 të datës 16.01.2023 ka propozuar të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

- Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, të cilat do e kishin e kushtëzuar anulimin e tij.

Mbrojtësja e të akuzuarit E. O. av. N. M. e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke pretenduar që i akuzuari gjatë gjithë deklaramit të tij ka theksuar se e ka gjendjen e vështirë ekonomike dhe se problemet dhe kundërthëniet në familje kanë ardhur pikërisht për shkak të vështirësive ekonomike. Gjykata me rastin e marrjes së dënimit nuk i ka marr për bazë rrethanat lehtësuese, pra nuk e ka marr për bazë gjendjen e vështirë ekonomike të të akuzuarit. I propozon Gjykatës së Apelit të Kosovës, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit të i shqiptoj dënim më të ultë.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit, për shqiptimin e një dënimi më të ultë, janë të pabazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e cila do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi më të ulët, ndaj të akuzuarit. Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit e duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, konform të dispozitës së nenit 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka shpreh keqardhje për rastin e

ndodhur dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej veprime të kundërligjshme si dhe qëndrimin e tij korrekt gjatë procesit gjyqësor, ndërsa prej rrethanave rënduese gjykata mori për bazë dhunën e krijuar brenda marrëdhënies familjare e të cilat vepra janë në rritje e sipër në territorin e kësaj gjykate, si dhe rrezikun e lartë shoqëror nga kryerja e kësaj vepre penale, ku i pandehuri në vazhdimësi për shkak xhelozie i shënon mesazhe me përmbajtje kërcënuese të dëmtuarës, me ç rast ndaj të dëmtuarës ka shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri për jetë, e bazuar në rrethanat e lartcekura gjykata e shkallës së parë i shqiptoi të akuzuarit dënim sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar me bindjen se edhe me këtë dënim të tillë do arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, si dhe duke pas parasysh faktin se në ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit nuk theksohet ndonjë rrethanë e re lehtësuese e cila nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë dhe e cila do të kishte me pas ndikim në shqiptimin e dënimit më të ultë, andaj sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate të gjitha këto japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar si dhe dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutorë dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me këtë kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tij, me çka do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë dhe në bazë të nenit 401 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti i Përgjithshëm

PA1.nr.1924/22, më datë 12.05.2023

Zyrtarja ligjore:

Rrezarta Bala

Anëtarët e kolegjit:

Skender Çoçaj

Kryetare e kolegjit:

Kadrije Goga Lubishtani

Ferit Osmani
